



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Select Prima" Sh.P.K. të datës 27.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal LOT I-VII" me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Select Prima" Sh.P.K. të datës 27.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal LOT I-VII" me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimtit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Select Prima" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.03.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal LOT I-VII" me nr. të prokurimit 616-25-1800-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Trashësia optimale e vijave plastike (2-3 mm)

- Trashësia 3-5 mm është më e ndjeshme ndaj presionit të gomave dhe forcave tangjenciale, duke rritur mundësinë e dëmtimit dhe shkëputjes nga sipërfaqja e rrugës.
- Shtresat më të trasha janë më të prirura ndaj deformimeve termike, çarjeve dhe ngritjeve nga rruga, veçanërisht në kushte të motit ekstrem.
- Trashësia 2-3 mm siguron integrim më të mirë me sipërfaqen e rrugës, duke reduktuar ndikimin e forcave mekanike dhe duke rritur jetëgjatësinë e vijave rrugore.
- Standardet ndërkombëtare (FHWA dhe EN 1436) rekandomojnë këtë trashësi për të garantuar balancën më të mirë mes qëndrueshmërisë dhe rezistencës ndaj konsumit.

Metoda Spray si opson efikas i aplikimit

- Metoda Spray ka demonstruar rezultate të shkëlqyera në aplikimet e mëparshme dhe është pranuar nga Komuna e Prishtinës si një metodë efikase.
- Kjo metodë siguron një trashësi uniforme prej 2-3 mm dhe një ngjiturë më të mirë me sipërfaqen e rrugës.
- Efikasiteti i saj në terren e bën të domosdoshme përfshirjen e saj si opson në specifikimet teknike, duke mos e kufizuar aplikimin e saj.

Ceshtja e trashesise se vijave te plastifikuar dhe menry e aplikimit permes sistemit Spray eshte argumentuar edhe me heret te Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtines, Departamenti i Prokurimit me date 24. 1 1.2022, dhe duke shqyrtaur kerkesat ne fiale vendos si me poshte; Kjo eshte pergjigja nga AK Komuna e Prishtines me dt.24.11.2022

AK ka percaktuar specifikat duke ubazuar ne standardet dhe kerkesat per realizimin eprojektit

Kërkesë për rishqyrtim

Duke marrë parasysh këto argumentet e arteshemuara, kërkojmë:

1. Përshtatjen e specifikimeve teknike për të lejuar trashësinë optimale prej 2-3 mm, si zgidhjen më të qëndrueshme dhe ekonomike.
2. Përfshirjen e metodës Spray si një opson i avancuar për aplikimin e vijave rrugore plastike, pa kufizime të panevojshtme.
3. Përdorimin e materialeve plastike me cilësi të lartë dhe me garanci të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të sinjalizimit rrugor.

Fillimi si duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesës për kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

A. Masa Plastik, duhet të jete e ngurt. Trashesia e vendosjes duhet te jete nga 0.3-0-5 mm me grimca të qelqit dhe rërës (12 muaj garacion), para ekzekutimit, masa plastike.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimi si duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin përcaktimëve të njësisë kërkuese të reflektuara në paramasë.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimi si duhet sqaruar se trashësia e masës plastike është përcaktuar nga njësia kërkuese përmes ekspertëve të fushës. Megjithatë në formulimin e kërkesës kontestuese është gjetur se dimensionet janë përcaktuar si vijon "0.3-0-5mm". Pra nuk është e qartë nëse trashësia duhet të jetë 0.3mm deri 0.5 mm apo duhet të jetë 0 deri në 5 mm. Prandaj ky gabim do të korrigohet në paramasë si dhe do të shtyhet afati për hapjen e ofertave në përputhje me LPP dhe RRPP.

Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Po ashtu lidhur me lejimin e përdorimit të metodës "spray", duke marrë parasysh që edhe në aktivitetet e prokurimit të ngashme si kjo në të kaluarën është lejuar përdorimi i kësaj metode, atëherë paramasa do të korrigohet ashtu që ndër të tjera do të lejohet edhe përdorimi i metodës në fjalë në përputhje me kërkeshat tjera të DT dhe specifikat teknike të detyrueshme të përcaktuara me DT.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënati më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.04.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks.gov.net